

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Autoriteti Kontraktor i cili do të jetë Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (Fondi), nuk mund të bëjë planifikimin e udhëtimeve që do të realizojnë punonjësit, pasi për nga vetë natyra e këtyre aktiviteteve, vendi dhe numri i punonjësve caktohet vetëm pak kohë para zhvillimit të tij. Fondi nuk mund të përcaktojë sasinë totale të biletave, vendin dhe datën e udhëtimeve.

Ky shërbim do të kryhet në të gjitha shtetet e botës si destinacione të mundshme.

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në mënyre periodike do të evidentojë kërkesa për blerjen e biletave. Këto kërkesa do të mbështeten në bazë të aktiviteteve që do të zhvillojë ky institucion. Procesi i rihapjes së konkurimit për lidhjen e kontratës do të zhvillohet sa herë që Fondi do të ketë nevojë/kërkesa dhe të dhëna të mjaftueshme për blerje biletash.

Kriteri i përcaktimit të ofertës fituese për kontratën e bazuar në Marrëveshjen Kuadër, në fazën e rihapjes së konkurimit do të jetë çmimi më i ulët.

Public Health Sector

Për fluturimet e stafit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, ka këto kërkesa të detyrueshme:

1. Trajtimi i kërkesave për bileta avioni nga Agjensia, dërguar nga Fondi do të bëhet me email, fax apo formë shkresore sipas kërkesave të mëposhtme:
 - Bileta avioni sipas kërkesave të përcaktuara nga Fondi;
 - Rezervimet do të bëhen në klasin ekonomik gjithmonë me çmimin më të ulët të mundshëm;
 - Çdo ofertë në fazën e minikonkurrencës do të shoqërohet me afatin për të cilin mund të mbahet e rezervuar;
 - Rezervimet duhet të mbahen për periudhën për të cilën linjat ajrore e ofrojnë;

- Itinerararet duhet të jepen në gjuhën angleze (dhe në gjuhën shqipe nëse do të jetë e mundur), duke treguar kohën e nisjes/mbërritjes (sipas orës lokale), çmimin e kuotuar duke përfshirë tarifën + taksat dhe afatin përfundimtar për lëshimin e biletës;
 - Duhet të përcaktohen miljet e fluturimeve / pasagjer. Përfituesi i vetëm i miljeve të parashikuara për fluturimin e kërkuar nga Fondit do të jetë pasagjeri i këtij institucioni, i cili do të udhëtojë dhe që disponon kartën e klientit të kompanive të ndryshme ajrore;
 - Për biletat e papërdorura ose të anuluar nga ana e Fondit do të bëhet rimbursimi i të gjitha taksave aeroportuale, nëpërmjet Agjensisë së udhëtimit që ka lëshuar biletën, etj, sipas përcaktimeve të kompanive ajrore;
 - Agjencia e udhëtimit duhet të sigurojë çmimin më të ulët të kuotuar për çdo destinacion nëpër botë, sipas kërkesës së Fondit;
 - Përdorimi i biletave elektronike do të jetë standard dhe duhet të dërgohet me email në të paktën dy adresa të Fondit, të cilat do të përcaktohen në kërkesën për mini konkurrencë.
 - Operatorët, palë e Marrëveshjes Kuadër, në fazën e mini konkurrencës duhet të kuotojnë një çmim total, sipas të cilit tarifa do të jetë për biletë të lëshuar dhe ku do të fitojë çmimi më i ulët;
 - Çmimet e ofruara do të përfshijnë vlerën totale të bileave, të shprehur në lekë.
2. Për çdo rast udhëtimi, operatori ekonomik duhet të specifikojë paraprakisht penalitetet e parashikuara, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fluturimit, orarit të biletës dhe të ditës së fluturimit.
 3. Rezervimi dhe shërbimi i biletarisë duhet të furnizohen gjatë 7 ditëve të javës, 24/24 orë, ku përgjigja do të jetë jo më shumë se 2 orë pas marrjes së kërkesës.
 4. Operatorët Ekonomik palë të Marrëveshjes Kuadër duhet t'i përgjigjen menjëherë kërkesave të Fondit për sa i përket menaxhimit financiar të Marrëveshjes Kuadër.
 5. Operatorët Ekonomik me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër duhet të përcaktojnë adresat e kontaktit me Fondin.
 6. Agjencia duhet të dërgojë rregullisht (një herë në muaj) pranë Fondit, informacion mbi:
 - a) Vështrimin e përgjithshëm të situatës aktuale të tregut ajror, kryesisht në Evropë (destinacione të reja të linjave ajrore, çmimet zbritje, ofertat speciale, promovime, etj);
 - b) Statistikat mujore mbi shpenzimet e udhëtimit të kryera nga Fondit;
 - c) Greva të njoftuara, ndërprerje të linjave të fluturimit, etj, sa herë të jetë e mundur.

7. Shërbimet do të ofrohen duke u bazuar në vendodhjen e Agjensisë së udhëtimit.
8. Agjensia e udhëtimit (fituese i Mini-konkursit për çdo kërkesë) do të dorëzojë një faturë të veçantë elektronike për çdo biletë të lëshuar në të paktën dy adresa e-maili të veçanta të përcaktuara nga Fondi. Kjo faturë duhet të tregojë shumën totale në lekë dhe referencat siç janë të specifikuara nga Fondi. Qëllimi i vetëm i kësaj fature elektronike është për të sinjalizuar përfundimin e transaksionit.
9. Fushëveprimi dhe kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër: Fondi do të lidhë Marrëveshje Kuadër për një periudhë dy vjeçare.

